

Pasi zgjodhi në krye të AMA-s zëdhënësen e tij, pasi kontrolloi pjesën më të madhe të medias, për më tepër pasi ndërtoi Agjencinë për Media dhe Informim, buxheti i së cilës mbahet sekret dhe nuk gjendet në asnjë pikë të tabelave të buxhetit, Rama sot, sipas vetë medieve, ka emëruar në krye të RTSH-së njeriun e tij me një procedurë tërësisht antiligjore dhe antistatutore. E them këtë, sepse Këshilli Drejtues i Radiotelevizionit Shqiptar në këto momente përbëhet vetëm nga 9 anëtarë, nga 11 që duhet të jenë. Komisioni i Medies, në të cilin bëj pjesë, ka kërkuar njëkohësisht riformatimin e Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar, kryetari i së cilës, sepse edhe ai është antistatutor dhe i paligjshëm, sipas ligjit të medias zgjidhet kur anëtarësia e Këshillit Drejtues është e plotë, por në momentin që ai është zgjedhur kanë munguar 4 anëtarë të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar. Por dëshira e Ramës për të kontrolluar median dhe për të realizuar propagandën nuk njih kufij, kështu që i duhej edhe kjo gërdalla mediatike me vete dhe thotë që e ka marrë. Thirrja dhe kërkesa jonë është që procesi të konsiderohet nul, të riformatohet Këshilli Drejtues i Radiotelevizionit, sepse nuk përfaqësohet vullneti i opozitës, dhe më pas të vijojnë me procedurat e zgjedhjes së drejtuesit të kësaj gërdalla mediatike, e cila, në fakt, nuk duhet t'i mbesë maxhorancës, jo PS-së, por t'i kthehet publikut, sepse është Radiotelevizioni Shqiptar, është i publikut shqiptar. Po ju nuk pyesni, sepse po i referohem prapë atij faktit që solla, pasi u keni grabitur 90 bilionë dollarë shqiptarëve sot vini dhe u vini në kurriz edhe këtë buxhet borxh, sepse me borxhe e keni ngritur buxhetin.

Përderisa një pjesë vazhdon t'ju duartrokasë e jo t'ju votojë, sepse votat ju i vidhni, nuk jua japin me dëshirë, mendoni se kurrizi i tyre, si ajo barsolëta e para viteve 1990, mban borxhe akoma më shumë. Vini këtu dhe parakaloni me fjalë false, me buzëqeshje false, me shifra të fryra, flisni për miliona e miliarda, madje si në lojë bixhozi. Kryeministri thotë miliona dollarë, ministrja e Financave thotë euro, ministrja e Arsimit thotë lekë, pastaj ka lekë të rinj dhe të vjetër dhe nuk po arrijmë ta marrim vesh se cili është etaloni juaj monetar që përdorni ju për buxhetin, sepse unë nuk e kam kuptuar përgjatë fjalës suaj një gjë të tillë. Ata që na dëgjojnë, pjesa më e madhe e këtij vendi, të cilët në darkë numërojnë qindarkat dhe bëjnë llogaritë nëse do ta blejnë dot bukën ditën e nesërme, në fakt, ju dëgjojnë me vëmendje. Kur ju dëgjojnë ju, duhet thënë, për hir të së vërtetës, për kaç miliona e miliarda sytë u vishen me njëlloj tisi krenarie, sepse atdheu i tyre qenka i kamur, paska shumë para kjo qeveria jonë dhe për një moment ndihen të pasur, por e nesërmja vjen shpejt dhe ajo gunga e peshës së borxhit që kanë në kurriz ua fik shpresat dhe ata e kuptojnë që nuk janë të pasur, por janë të grabitur, u janë grabitur miliona. Janë grabitur, sepse a e dini se çfarë bëni ju? Ju flisni për miliona e miliarda dhe u lini atyre vetëm zerot. Zero shërbime shëndetësore, zero shërbime në arsim, zero në punësim, zero shpresa, zero të ardhme, ndërsa milionat dhe miliardat i ndani vetë me klientët tuaj, i bëni prona, i bëni koncesione dhe ndërtoni kulla, kjo është e vërteta. Falë zemërgjërësisë suaj, këto zerot, siç jua thashë, ua lini njerëzve të thjeshtë, të cilët me zero hyjnë dhe me zero dalin nga ky buxhet, duke filluar nga mësuesit e duke mbaruar me atë policin e Gardës që e kemi këtu, i cili nuk ka asnjë lloj rritjeje page dhe nuk e konsideron njeri. Sigurisht, vini këtu e përrallisni shumë bukur, pasi doni që korbit që keni në krye t'i zbardhni pendët, por ju ka dalë boja dhe e zeza nuk ju shpëton nga kjo histori.

Nuk ju shpëton as fjala dhe fjalët e bukura për arsimin. Unë para se të atakoj atë buxhet minimal për arsimin, dua t'ju të them disa nga arritjet tuaja historike që keni për arsimin gjatë këtyre viteve. Për 2

vjet dështuat komplet me mësimin online. Çfarë keni bërë? Keni shtuar klasat kolektive në maksimum dhe mësimin me turne. Në shkollat tona, vetëm një fakt po ju sjell, meqenëse ministren e kemi nga Elbasani, por për momentin ajo nuk është e pranishme në sallë, në Tregan 140 fëmijë bëjnë 12 kilometra për ditë që të bëjnë shkollën pasdite me orë vetëm 25-minuteshe. 140 fëmijë që duhet të luajnë me fëmijët e tjerë “Kala dibrance” te shkolla tjetër, ndërsa ju vini e flisni këtu për arritje. Çfarë keni bërë tjetër në arsimin e lartë, sepse flisni për ndërkombëtarizim? Keni goditur kombëtarizimin e arsimit, keni mbyllur degën Gjuhë-Letërsi në universitetet e rretheve, keni mbyllur degë të tjera, si: Histori, Gjeografi, Matematikë, Fizikë, Biologji, Kimi, Psikologji, Filozofi. Ju i keni mbyllur dhe sot këto degë nuk ekzistojnë dhe flisni ju për filiale ndërkombëtare. Universitetet publike i keni kthyer në kolegje publike, nuk ka kërkim shkencor, realisht janë kolegje, atëherë çfarë marrëdhënies bilaterale do të bëjnë me universitetet e njohura ndërkombëtare kur nuk kanë vlerën e duhur? Kryeministri, i cili nuk di se nga lidhet gomari në arsim, e bën me qejf rolin e gomarit dhe bërtet se Shqipëria nuk ka nevojë për gjuhëtarë, historianë, psikologë, filozofë, jo, Shqipërinë do ta shpëtojë zejtarët, këpucarët, hekurkthyesit, të gjitha këto janë profesione të nderuara, dhe ata që punojnë me shporta, sepse janë zejtarë në programin dhe planin e këtij. Ju lutem, mos u tregoni kaq hipokritë kur flisni për revolucione, për buxhet të madh në arsim, sepse buxheti është i njëjtë si vitet e tjera, 2,8% e produktit të përgjithshëm bruto.

Pra, çdo vit me të njëjtin financim dhe ju sot kërkoni rezultate të ndryshme, por ky është budallallëk. Si mund të arrihet me të njëjtat para një rezultat i ndryshëm më i mirë se viti i kaluar, sepse jua listova se cilat janë sukseset tuaja. Gjithsesi, unë nuk do t’jua them me shifra, por do t’jua tregoj realisht, duke treguar abuzimin dhe pamjen tuaj se si është buxheti për arsimin, duke mos përdorur as euro, as dollarë dhe as lekë. A e dini sa para do të jepen për revolucionin digjital, siç e quan Kryeministri dhe ministrja? Aq para sa kushtojnë perdet, tapeti ose tapetet e Kryeministrisë dhe kolltukët të marra së bashku për atë revolucionin digjital, që ta dinë shqiptarët. Gallata për këtë revolucion është se Kryeministri di që revolucion është laborator dhe kompjuteri, pra nuk janë burimet njerëzore, programet, kurrikulat në të cilat duhet futur programimi dhe gjuha kompjuterike. Kryeministri nuk e di një gjë të tillë, por di që po të dërgohet një kompjuter është bërë revolucion, sepse deri tani nuk ka dërguar asgjë dhe e ka pranuar edhe vetë. Për arsimin profesional, sepse nuk flisni fare për arsimin profesional, a e dini se sa para do të hidhen? Do të hidhen aq para sa Rama i harxhon për 3 udhëtime charter, pra nuk po flas me shifra. Për pagat e mësuesve, që ministrja bërtet me përqindje, sepse nuk e tregon shifrën, a e dini sa para do të shpenzohen nga buxheti i shtetit? Aq para sa Rama i harxhon për gardërobën e tij, aq lekë do të marrin mësueset dhe mësuesit.

Ndërsa financimi për të gjithë arsimin e lartë së bashku me kërkimin shkencor, a e dini sa kushton në buxhet, bëni krahasimin? Sa 2 kilometra rrugë të florinjta të Unazës së Tiranës, ndërsa ju bërtisni revolucion, arsim i lartë, kërkim shkencor. Për librat falas që do të marrin fëmijët tanë në përdorim falas, në përdorim, janë dy terma që nuk shkojnë, por hajt e keni futur dhe kjo është risi, a e dini sa para do të harxhohen? Aq sa kushton një darkë te Nusreti i kabinetit, kaq para do të marrin fëmijët tanë. Këto janë ato sakrificat tuaja. Meqenëse nuk kam kohë, po e mbyll fjalën time, me një citim të Xhevahir Spahiut, ndërsa njerëzit që po na dëgjojnë, ata që harxhojnë çdo gjë, janë gati të marrin borxhe për fëmijët e tyre, sipas këtij poeti shesin edhe gurin e varrin të tyre për të larë borxhet, edhe tuajat, edhe të qeverisë, ndërsa ju bëni të kundërtën, ju jeni të gatshëm të shisni edhe gurët e varreve të tyre vetëm e vetëm që të pasuroheni vetë dhe të pasuroni klientët. Faleminderit!